VENDIM
Nr. 876, datë 11.11.2020

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA PROJEKTI: "RIKONSTRUKSION SHESHI 'ISMAIL QEMALI' DHE RRUGA 'VETERANI', BASHKIA POGRADEC"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga projekti: "Rikonstruksion sheshi 'Ismail Qemali' dhe rruga 'Veterani', Bashkia Pogradec".
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Pogradec.
3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit tokë "truall", me vlerë 4 107 226.5 (katër milionë e njëqind e shtatë mijë e dyqind e njëzet e gjashtë pikë pesë) lekë.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 4 107 226.5 (katër milionë e njëqind e shtatë mijë e dyqind e njëzet e gjashtë pikë pesë) lekësh, të përballohet nga llogaria "Fondi i shpronësimeve", në Bankën e Shqipërisë.
5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.
6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
7. Pronarët e pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit, pranë Bashkisë Pogradec.
8. Afati i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Pogradec.
9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në bashkëpunim me Bashkinë Pogradec, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë në favor të Bashkisë Pogradec.
10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar, deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të Bashkisë Pogradec.
11. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Pogradec për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA PROJEKTI:
"RIKONSTRUKSION SHESHI 'ISMAIL QEMALI' DHE RRUGA 'VETERANI', BASHKIA POGRADEC"

Çmimi për pasurinë "truall" është llogaritur sipas VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016.

Nr.	Emër, Atësi, Mbiemër	Zona kadastrale	N./pasurisë	Lloji i pronës	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera	Konfirmimi nga ASHK-ja
1	Agim Muhamet Prishtina, Petrit Muhamet Prishtina, Bukurie Tosum Prishtina, Lumturie Muhamet Prishtina, Luiza Muhamet Prishtina, Argjen Muhamet Prishtina	8581	5/279	truall	m^2	391.5	10491	4,107,226.50	Konfirmuar nga ASHK-ja me shkresën nr. 1266/1, datë 21.2.2019
Shuma totale e shpronësimit						**391.5**		**4,107,226.50**	